

Zhvillohet sesioni i dytë i trajnimit të audituesve të KLSH-së dhe ANAC mbi identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të korrupsionit, 28-30 mars 2022

Si pjesë e bashkëpunimit ndërmjet prezencës së OSBE-së në Shqipëri, KLSH-së dhe Autoritetit Anti-Korrupsion të Italisë (ANAC), u zhvillua sesioni i dytë i trajnimit të audituesve të KLSH-së dhe ANAC mbi identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të korrupsionit në fushën e prokurimit publik, me fokus në partneritetin publik-privat PPP.



Trajnimi u zhvillua në datat 28-30 mars 2022 me pjesëmarrjen e 50 audituesve nga KLSH ku u trajtuan tema si: vlerësimi i riskut në trajtimin e PPP-ve, planifikimi ekonomik dhe financiar, si edhe zbatimi dhe variacionet gjatë realizimit të një PPP-je. Ky trajnim i ofroi audituesve të KLSH-së mundësinë për të rritur kapacitetet e tyre profesionale nëpërmjet shkëmbimit të praktikave më të mira dypalëshe, KLSH – ANAC.

